



REPUBLIKA E SHqipëRISE  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

# UDHËZUES PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT LËNDOR DHE VLERËSIMIN E NXËNËSVE GJATË MËSIMIT NË KUSHTET E SHTËPISË

TIRANË

21.03.2020



## HYRJE

Ky udhëzues<sup>1</sup> ka për qëllim të orientojë mësuesit në punën e tyre virtuale me nxënësit e tyre në kushtet e shtëpisë.

Më poshtë jepen disa udhëzime në lidhje me vijueshmërinë e mësimit në kushtet e shtëpisë, me realizimin e programit lëndor të klasës përkatëse, si dhe me procedurat e vlerësimit të nxënësve në funksion të përmbushjes së kërkesave të kurrikulës.

Nga fillimi i javës së tretë të mësimit në kushtet e shtëpisë, mësuesit duhet të vlerësojnë pjesëmarrjen dhe gatishmërinë e nxënësve për të përgatitur rregullisht detyrat e dhëna, si dhe arritjet e tyre në nxënien e njohurive të fituara.


---

<sup>1</sup> Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të Urdhrit të MASR-së, Nr. 591, datë 09.03.2020, “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike”.



# 1. VIJUESHMËRIA E MËSIMIT NË KUSHTET E SHTËPISË

- a) Mësimi në kushtet e shtëpisë do të vijojë duke u bazuar në planin mësimor dhe në kalendarin e hartuar nga secila shkollë për lëndët dhe klasat përkatëse.
- b) Mësuesit ndjekin kalendarin e hartuar nga drejtoria e shkollës duke mbajtur shënim temën e zhvilluar për çdo orë mësimi në kushtet e shtëpisë dhe pjesëmarrjen e nxënësve.
- c) Mësuesit gjatë zhvillimit të mësimi në kushtet e shtëpisë (sipas skedës bashkëlidhur në shtojcën 2):
  - orientojnë nxënësit si të punojnë me tekstin, p.sh., mësuesi udhëzon nxënësit si të evidentojnë njohuritë dhe konceptet kryesore përgjatë informacionit të temës mësimore, të përdorin pyetjet e aparatit pedagogjik të tekstit për të zbuluar lidhjen dhe varësinë ndërmjet koncepteve/njohurive; drejton vëmendjen e nxënësve drejt figurave/fotografive/hartave/ diagrameve të tekstit në mënyrë që nxënësit të punojnë me to/t'i interpretojnë, të mbajnë shënim informacionin që është i pakuptueshëm për ta etj.;
  - ndajnë në një temë mësimi se çfarë mund të nxënë nxënësit në mënyrë të pavarur dhe se çfarë është e nevojshme të sqarohet nga ata, sqarojnë për nxënësit konceptet dhe njohuritë e vështira për ta, p.sh., paraprakisht mësuesi identifikon konceptet dhe njohuritë që ai konsideron kyç ose të vështira për nxënësit, ua shpjegon dhe, më pas, u kërkon nxënësve të identifikojnë konceptet/njohuritë për të cilat ata kanë nevojë të sqarohen më tej;
  - orientojnë nxënësit si të zhvillojnë ushtrimet ose detyrat në varësi të specifikave të lëndës. Nxënësit udhëzohen për hapat që duhet të ndjekin në kryerjen e detyrës, atyre u jepet një shembull ose një zgjidhje, si p.sh., nëse në një ushtrim kërkohet që të gjenden gjymtyrët e dyta, mësuesi jep një shembull duke sqaruar



çdo hap, ose, nëse në një ushtrim kërkohet të ndërtohet një grafik, jep një shembull për të gjithë hapat e ndërtimit të grafikut etj.;

- u përgjigjen pyetjeve të bëra nga nxënësit dhe i inkurajojnë nxënësit që të bëjnë pyetje (gjithmonë duke iu përmbajtur programit lëndor) etj.;
- vlerësojnë nxënësit, duke i motivuar dhe inkurajuar vazhdimisht ata.

d) Mësuesit hartojnë planifikimin e periudhës së tretë sipas kalendarit dhe e dorëzojnë online te drejtoria e shkollës.

e) Drejtoria e shkollës mbledh të gjitha planet e periudhës së tretë për të gjithë lëndët dhe klasat dhe i ruan në një dosje (folder) derisa të rifillojë procesi mësimor.


f) Nëpërmjet komunikimit online, mësuesit raportojnë çdo javë në drejtorinë e shkollës për ecurinë e procesit mësimor, për numrin e nxënësve me të cilët kanë mbajtur komunikime të rregullta si dhe evidentojnë nxënësit me të cilët nuk kanë pasur komunikim, shoqëruar me arsyen përkatëse.

g) Drejtorët e shkollave raportojnë çdo javë në ZVA, për shtrirjen e mësimit online, problematikat dhe rezultatet.

h) ZVA-të raportojnë çdo javë në DRAP dhe DRAP-të në DPAP, për shtrirjen e mësimit online, problematikat dhe rezultatet.


## 2. REALIZIMI I PROGRAMIT LËNDOR

a) Mësuesi realizon temat mësimore sipas planifikimit në planin e periudhës duke u përqendruar në njohuritë kryesore, në orët e përsëritjes apo në zbatimin e njohurive. Plani i periudhës ka të njëjtin format dhe rubrika sikurse planet e



periudhave të mëparshme. Mësuesi bën kujdes të pasqyrojë në të temat mësimore, të cilat mund të përfshijnë:

- temat për njohuritë e reja,
  - orët e përsëritjes/përforcimit,
  - orët e punëve praktike (në varësi të specifikave të lëndës) që mund të kryhen në kushtet e shtëpisë;
  - orë ushtrimesh (në varësi të specifikave të lëndës);
  - situata të të nxënit ose veprimtari praktike që mundësojnë lidhjen e njohurive me jetën e përditshme (në shtojcën 1 janë dhënë disa shembuj veprimtarish në disa lëndë);
  - metoda/teknika që do të përdoren për trajtimin e temave mësimore në përgjithësi p.sh., diskutim, punë individuale, video të dërguara online nga mësuesi apo nxënësi, harta e koncepteve, kllaster, INSERT etj., në varësi të specifikave të lëndës;
  - burimet e informacionit, ku përfshihen jo vetëm teksti, por dhe burime të tjera alternative plotësuese, në funksion të temave mësimore etj., që mund të gjenden në kushtet e shtëpisë;
  - teknika/instrumente që do të përdoren për vlerësimin e nxënësve, për periudhën në përgjithësi, p.sh., pyetje-përgjigje, kuiz, ese, zgjidhje ushtrimesh etj.;
- b) Temat mësimore që lidhen me veprimtari që zhvillohen jashtë kushteve të shtëpisë, zëvendësohen nga mësuesi me tema mësimore që kanë veprimtari që zhvillohen në kushtet e shtëpisë.
- c) Mësuesi mban shënime në fletoren e tij të planifikimit ditor të gjitha të dhënat për temën e mësimit që ka kryer, në mënyrë që ta ketë të lehtë pasqyrimin e këtyre temave në regjistrin përkatës të klasës në momentin e rifillimit të procesit mësimor.
- d) Në varësi të specifikave të secilës lëndë, mësuesi zëvendëson orët e projektit me detyra krijuese ose hulumtuese që mund të zhvillohen në kushtet e shtëpisë.



### 3. PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE NË KLASAT 1-3

- a) Vlerësimi i nxënësve në klasat 1-3 do të bëhet mbi bazën e shënimeve që mësuesi ka mbajtur në fletoren personale gjatë periudhës kur mësimi është zhvilluar në shkollë, si dhe në vlerësimet që mësuesi mund të ketë kryer gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë (përfshirë pjesëmarrjen në mësimin online dhe vlerësimet e detyrave të shtëpisë).
- b) Testimi për lëndën e gjuhës shqipe dhe të matematikës do të zhvillohet online me nxënësit në komunikim të drejtpërdrejtë, ose me teste të thjeshta të dërguara në grupet e krijuara. P.sh., në shtojcën 1/f jepen disa shembuj të llojeve të pyetjeve që mund të përdorin mësuesit për testin përmbledhës në arsimin fillor.


### 4. PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE NË KLASAT 4-12

**Vlerësimi i vazhduar** do të bëhet mbi bazën e shënimeve që mësuesi ka mbajtur në fletoren personale gjatë periudhës kur nxënësit kanë qenë në shkollë, si dhe në vlerësimet që mësuesi ka kryer gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë, përfshirë vlerësimin e detyrave të shtëpisë si dhe gatishmërinë e nxënësve për të komunikuar me mësuesen dhe vlerësimin e detyrave të kryera prej tij.

Orientimi i nxënësve në lidhje me detyrat e shtëpisë të jetë sipas modeli të një pune të *diferencuar* dhe *individuale*. Kjo gjë synon:

- shmangien e kopjimit të detyrës nga njëri-tjetri,
- rritjen e vlerësimit korrekt e transparent,
- seriozitetin e punës.

Mësuesi shfrytëzon materialin për temën përkatëse në "Fletoren e punës" që shoqëron tekstin përkatës.



Mësuesi mund të përdorë si kriter vlerësimi edhe dorëzimin e detyrave të shtëpisë në afatin e caktuar. Kjo gjë synon:

- mbajtjen e nxënësve të angazhuar,
- vijueshmërinë e punës.


**Vlerësimi i portofolit** do të bëhet mbi bazën e detyrave që nxënësi ka dorëzuar gjatë periudhës kur ishte në shkollë, si dhe të detyrave krijuese që nxënësi mund të ketë kryer gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë.

Nëse ka raste që një detyrë krijuese ose një pjesë e projektit nuk është realizuar për shkak të ndërprerjes së procesit mësimor, ose nuk mund të kryhet në kushtet e mësimin në shtëpi, mësuesi e zëvendëson detyrën/projektin, ose bën vlerësimin e portofolit të nxënësit duke u bazuar vetëm në detyrat që janë realizuar.

Sugjerohet që projekti kurrikular të zëvendësohet me një detyrë krijuese/hulumtuese individuale, e cila mund të zhvillohet në kushtet e shtëpisë. Nëse zgjidhja e ushtrimeve, zhvillimi i detyrave apo realizimi i veprimtarive praktike kërkojnë që nxënësit të gjejnë informacion në burime të tjera të nxëni, mësuesi orienton nxënësit për këto burime, si p.sh., adresa web, libra etj., duke bërë kujdes që të konsultojë paraprakisht me nxënësit mundësitë që ata kanë për t'i siguruar ato.

**Mbani mend: Mësuesit duhet të bëjnë kujdes të mos mbingarkojnë nxënësit me detyra dhe, aq më tepër, me detyra që nuk mund të kryhen në kushtet e shtëpisë.**

**Vlerësimi me test ose i detyrës përmbledhëse** do të kryhet në kushtet e shtëpisë. Ky vlerësim do të përmbajë vetëm çështjet kryesore të zhvilluara për të gjithë periudhën përkatëse (nëse mësuesit nuk e kanë zhvilluar akoma) që përfshijnë njohuritë që nxënësi ka fituar kur ka zhvilluar mësimin në shkollë dhe njohuritë më kryesore që nxënësi ka marrë gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë.



a) Mësuesi përcakton:

- datën/datat e zhvillimit të testit/detyrës përmbledhëse;
- orarin e zhvillimit të testit/detyrës përmbledhëse;
- kohën sa do të zgjasë testi/detyra përmbledhëse;
- mënyrën e organizimit të testit/detyrës përmbledhëse.

Mësuesi i sqaron nxënësit duke iu përgjigjur me kujdes çdo pyetjeje që nxënësit mund të kenë lidhur me testin/detyrën përmbledhëse apo paqartësi për çështjet e përcaktuara.


***Mbani mend: Është e rëndësishme që mësuesit të vlerësojnë edhe njohuritë e nxëna gjatë periudhës së mësimit në kushte shtëpie, për të nxitur nxënësit të punojnë me seriozitet, si dhe për të orientuar punën e mëtejshme në bazë të njohurive që nxënësit kanë nxënë gjatë punës në shtëpi.***

b) Mësuesit e lëndëve të fushave “Gjuhët dhe komunikimi”, “Matematika” dhe “Shkencat e natyrës” do të vendosin nëse zhvillojnë me nxënësit teste ose detyra përmbledhëse (sipas specifikave të lëndës).

c) Mësuesit e lëndëve të fushave “Shoqëria dhe mjedisi”, “Arte”, “Teknologji dhe TIK”, “Edukim fizik, sporte dhe shëndeti” etj., NUK do të zhvillojnë teste, por detyra përmbledhëse, në mënyrë që nxënësit të mos ngarkohen me teste për të gjitha lëndët.

d) Për të zhvilluar testin ose detyrën përmbledhëse në kushtet e shtëpisë:

- mësuesi liston çështjet për të cilat nxënësit duhet të përgatiten duke u fokusuar në konceptet më kryesore;
- mësuesi njofton nxënësit për çështjet kryesore të përzgjedhura për periudhën përkatëse;






- nxënësi, në komunikim të drejtpërdrejtë në rrjete sociale, i përgjigjet mësuesit brenda 3-5 minutave për koncepte kryesore të njërës nga çështjet që mësuesi i përzgjedh aty për aty;
- mësuesi vlerëson nxënësin dhe ia komunikon atij këtë vlerësim.

Kjo metodë i mundëson mësuesit të vlerësojë të gjithë nxënësit për një periudhë kohore relativisht të shkurtër dhe mbështetet nga komunikimi online që po zhvillohet në këtë fazë. Në shtojcën 1 jepen shembuj lëndësh se si mund të organizohen testet ose detyrat përmbledhëse.

## 4.2. MBAJTJA E NOTAVE TË PERIUdhËS GJATË MËSIMIT NË KUSHTET E SHTËPISË, SI DHE RAPORTIMI I TYRE TE NXËNËSIT DHE TE PRINDËRIT

- a) Drejtoria e shkollës përgatit një format evidence përmbledhëse të periudhës, ku mësuesi do të hedhë notat e periudhës për secilin lloj vlerësimi: vlerësimit të vazhduar, vlerësimit të portofolit dhe vlerësimit të testit/detyrës përmbledhëse.
- b) Mësuesi vendos notat e vlerësimit të vazhduar; notat e vlerësimit të portofolit dhe notat për testin ose detyrën përmbledhëse në formatin e evidencës të përgatitur nga drejtoria e shkollës dhe ua bën të ditur nxënësve dhe prindërve, në mënyrë individuale.
- c) Mësuesi, mbasi hedh notat e periudhës në formatin e evidencës të përgatitur nga drejtoria e shkollës, e dorëzon atë te stafi drejtues në version online.
- d) Drejtoria e shkollës mbledh të gjitha vlerësimet me notë të vlerësimit të vazhduar, të vlerësimit të portofolit dhe të testit/detyrës përmbledhëse (nëse është kryer) për të gjitha lëndët dhe klasat për periudhën e dytë dhe i ruan në një dosje (folder) të vlerësimeve të nxënësve, derisa të rifillojë procesi mësimor.




## 5. KLASAT KOLEKTIVE

- a) Mësuesit që punojnë me klasat kolektive, mund të krijojnë grup vetëm me nxënësit e së njëjtës klasë, ose do të punojnë individualisht me nxënësit. P.sh., nëse në një klasë kolektive ka 2 nxënës klasa e parë, 3 nxënës klasa e tretë dhe 1 nxënës klasa e pestë, mësuesi do të krijojë grup të veçantë për klasën e parë, grup të veçantë për klasën e tretë dhe do të punojë individualisht me nxënësin e klasës së pestë.
- b) Mësuesit që punojnë me klasa kolektive, do të zbatojnë të gjitha udhëzimet e mësipërme në lidhje me vijueshmërinë e mësimi në kushtet e shtëpisë, me realizimin e programit mësimor dhe me procedurat e vlerësimit të nxënësve.
- c) Në varësi të numrit të nxënësve, si dhe të specifikave të klasës dhe të zonës, mësuesi mund të zgjedhë formën, mënyrën dhe mjetet e komunikimit me nxënësit/prindërit. Është e rëndësishme që nxënësit në zonat rurale të vijojnë procesin e mësimi në kushtet e shtëpisë dhe të udhëzohen në vazhdimësi nga mësuesit.

## 6. NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Mësuesit ndihmës që punojnë me nxënësit me aftësi të kufizuara:

- Realizojnë planin edukativ individual (PEI), sipas mundësive dhe veçorive të çdo nxënësi duke komunikuar në mënyrë individuale me të dhe me prindin e nxënësit;
- hartojnë planifikimin e periudhës, bazuar në PEI-n për çdo nxënës dhe e dorëzojnë online në drejtorinë e shkollës.
- mbajnë shënime në fletoren e tyre të dhënata për punën e kryer me nxënësin deri në momentin e rifillimit të procesit mësimor;
- informojnë çdo javë mësuesin kujdestar dhe drejtorinë e shkollës për ecurinë në kushtet e shtëpisë të nxënësit me aftësi të kufizuar.



## 7. SHTOJCA

### 7.1. Për testin ose detyrën përmbledhëse


#### a. Gjuhë shqipe dhe letërsi

Për vlerësimin me test përmbledhës në lëndën e gjuhës shqipe, mësuesi përzgjedh:

- 2-3 tekste (letrare dhe joletrare) nga teksti shkollor dhe çështjet/aspektet për të cilat duhet të përgatiten nxënësit. P.sh., për tekstin letrar jepen: subjekti; analiza e personazheve; përshkrimi i kohës dhe i vendit; lidhja e tekstit me jetën e përditshme; tema, motivet, mesazhi dhe interpretimi i tyre; identifikimi dhe analiza e tipareve gjuhësore të tekstit etj.
- 10 ose pak më shumë ushtrime që kanë lidhje me njohuritë dhe aftësitë e nxënësve rreth sistemit gjuhësor të shqipes. P.sh., nëse gjatë periudhës së dytë mësuesi ka zhvilluar llojet e fjalive të përbëra, ai përzgjedh nga teksti shkollor ushtrime që kërkojnë nga nxënësit t'i dallojnë e t'i analizojnë ato, të ndërtojnë skemën dhe të formojnë fjali të përbëra.

Për vlerësimin me portofol në lëndën e gjuhës shqipe, mësuesi përzgjedh:

- projekte ose detyra portofoli, të tilla si: *Mbledhja e disa fjalëve të urta nga gjyshi/gjyshja; Shkrimi i një poezie/tregimi ose proze poetike për luftën e njerëzimit me Covid-19; Kategorizimi i informacioneve në një rrjet social në të besueshme dhe jo të besueshme;*
- biseda letrare rreth një libri që nxënësit e kanë në shtëpi dhe që mund ta prezantojnë shkurtimisht për të tjerët;
- Shkrimi i një teksti argumentues: *“Pse njeriu do ta fitojë luftën me Covid-19?”*.



Mësuesi përcakton edhe kriteret e vlerësimit sipas niveleve të arritjes dhe konvertimin në notë për të ruajtur parimin e transparencës dhe objektivitetit në vlerësim.

### **b. Matematikë**


Për vlerësimin me test përmblendhës në lëndën e matematikës, mësuesi përzgjedh çështjet kryesore që do të kontrollohen. P.sh., për derivatin, integralin, eksponencialin dhe logaritmin (klasa 12), mësuesi liston konceptet kryesore për këto çështje në varësi të përmbushjes së rezultateve të të nxënit të kompetencave matematikore dhe ua prezanton nxënësve duke dhënë sqarimet përkatëse, si më poshtë:

- Njehsimi i derivatit të një funksioni.
- Ekuacioni i tangjentes dhe pingules në një pikë të vijës.
- Monotonia e funksionit.
- Ekstremumet.
- Njehsimi i integralit të një funksioni.
- Njehsimi i syprinës nën një vijë.
- Logaritmi dhe vetitë e tij.
- Eksponenciali dhe vetitë e tij.
- Ekuacionet dhe inekuacionet eksponenciale dhe logaritmikë.
- Proceset eksponenciale.

Lidhur me këto çështje, mësuesi mund të hartojë një grup ushtrimesh, situatash problemore nga jeta reale (p.sh., 2-3 ushtrime për secilin koncept), i pikëzon secilin prej tyre, i udhëzon nxënësit dhe ua jep atyre për t'i zgjidhur duke u lënë një afat të përcaktuar.

Mësuesi përcakton edhe kriteret e vlerësimit sipas niveleve të arritjes dhe konvertimin në notë për të ruajtur parimin e transparencës dhe objektivitetit në vlerësim.

Më pas, në datat dhe orarin e përcaktuar prej tij, mësuesi zhvillon testin përmblendhës duke komunikuar me nxënësin dhe duke i dhënë aty për aty të zgjidhë 1-2 ushtrime (në



varësi të llojit të ushtrimit). Mësuesi u komunikon nxënësve rezultatin dhe vlerësimin përkatës duke bërë komentet e nevojshme për arritjet e tyre.

### **c. Gjeografi**

Për vlerësimin me detyrë përmbledhëse në lëndën e gjeografisë, si pjesë e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, mund të përdoret detyrë e tipit ese ose veprimtari praktike etj. Përmes saj, mësuesi vlerëson grupin e rezultateve të të nxënimit të periudhës që ka veçuar si më të rëndësishme, në varësi të rezultateve të të nxënimit që ka planifikuar të përmbushë për atë periudhë.


*Shembull:*

*Detyrë përmbledhëse, klasa e 9-të*

Pasi nxënësit kanë zhvilluar gjatë periudhës njohuritë dhe aftësitë për rajonet e Republikës së Shqipërisë, mësuesi jep *një detyrë përmbledhëse të tipit ese argumentuese me temë: “Perspektiva e zhvillimit të turizmit të Rajonit ... të Republikës së Shqipërisë”.*

Për realizimin e detyrës, mësuesi:

- a) Udhëzon nxënësit që secili prej tyre është i lirë të përzgjedhë njërin prej rajoneve të Republikës së Shqipërisë të cilin do ta marrë në shqyrtim. Mbi bazën e njohurive dhe aftësive që ka zhvilluar nxënësi në lidhje me veçoritë natyrore, popullsinë, ekonominë, trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajonit të përzgjedhur prej tij, ai duhet të gjykojnë mbi perspektivën e zhvillimit të turizmit të këtij rajoni.
- b) Mësuesi harton paraprakisht kriteret e vlerësimit të detyrës sipas niveleve të arritjeve dhe konvertimin në notë dhe ua komunikon nxënësve.
  - Mësuesi përcakton kohën e nevojshme për kryerjen e detyrës dhe ua komunikon nxënësve.



- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale për të shprehur dhe argumentuar mendimin e tyre dhe dërgojnë esenë e përgatitur te mësuesi.
- Mësuesi, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, vlerëson detyrën dhe, në ditët në vazhdim, ia komunikon nxënësit rezultatin, duke bërë komentet e nevojshme.

#### ***d. Histori***


Për zhvillimin e mësimit në kushtet e shtëpisë në lëndën e historisë, mësuesi:

- orienton nxënësit të përdorin tekstin si burim historik për të gjetur në të konceptet kryesore të përcaktuara paraprakisht nga ai vetë;
- drejton nxënësit të përcaktojnë periudhën kohore dhe vendin ku zhvillohet ngjarja historike;
- trajton ngjarjen historike duke analizuar lidhjet shkak-pasojë;
- sqaron rëndësinë e ngjarjes historike;
- drejton vëmendjen e nxënësve drejt pyetjeve të aparatit pedagogjik, fotografive dhe ilustrimeve në tekst;
- interpreton ngjarjen historike dhe sqaron konceptet të cilat nxënësit i kuptojnë me shumë vështirësi.

Për lëndën e historisë, mësuesi parashikon zhvillimin e veprimtarive praktike të përcaktuara në program dhe të zhvilluara në tekst. Për këtë, gjatë përgatitjes ditore dhe komunikimit online me nxënësit, ai bën kujdes që, paraprakisht, të përcaktojë konkretisht se çfarë detyre do të zhvillojë çdo nxënës, si dhe burimin me të cilin do punojë nxënësi për realizimin e veprimtarisë. Mësuesi përcakton afatin e përgatitjes së nxënësve për veprimtarinë dhe ditën e dorëzimit të saj.

#### ***Për vlerësimin me detyrë përmbledhëse në lëndën e historisë***

- a) Pjesë e detyrës përmbledhëse mund të jetë dhe veprimtaria praktike, sipas detyrës që mësuesi i ka përcaktuar çdo nxënësi të kryejë, duke u bazuar në burimin historik



të dhënë nga mësuesi paraprakisht për realizimin e detyrës. Nxënësit u përgjigjen një sërë pyetjesh të përgatitura nga mësuesi, si p.sh.:

- Çfarë burimi keni përdorur?
- Cilat janë konceptet historike kyç që keni gjetur në këtë burim?
- Në çfarë periudhe kohore shtrihet ngjarja?
- Rendit informacionin historik për vendet dhe periudhat e përfshira në burimin e dhënë duke përfshirë të dhënat dhe konceptet më të rëndësishme.
- Cilat janë shkaqet që ndodhi...?
- Cilat qenë pasojat...?

***Në këtë mënyrë, mësuesi vlerëson jo vetëm për njohuritë e fituara, por dhe për kompetencat dhe konceptet historike kyç, si kërkimi; përdorimi i burimeve, kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia, interpretimi historik, analiza shkak-pasojë.***

b) Mësuesi, sipas temave që ka paracaktuar paraprakisht të vlerësojë, i rendit ato në mënyrë të çrregullt. Nga nxënësi kërkon:

- Rendit ngjarjet, faktet, figurat dhe zhvillimet historike sipas kronologjisë.
- Rendit ngjarjet, faktet, figurat dhe zhvillimet historike sipas rëndësisë historike të ngjarjes.

***Nxënësit, në këtë mënyrë vlerësohen për konceptet historike kyç, si kronologjia dhe rëndësia historike si dhe kompetencat e lëndës.***

c) Për një grup temash të caktuara, mësuesi i kërkon nxënësit:

- të përdorë tekstin si burim informacioni për të kërkuar dhe gjetur në tekst konceptet dhe termat historike kyç dhe të shpjegojë dy prej tyre. Pasi nxënësi t'i ketë gjetur në tekst konceptet kyç, mësuesi vendos se cilin koncept do të shpjegojë nxënësi.



**Në këtë mënyrë, mësuesi vlerëson jo vetëm për njohuritë e fituara, por dhe kompetencat historike, si: kërkimi; përdorimi i burimeve dhe interpretimi historik.**

- d) Për një temë të caktuar, mësuesi i kërkon nxënësit të shpjegojë shkaqet dhe të analizojë pasojat e asaj ngjarjeje historike.
- e) Evidenton për një periudhë të caktuar historike ngjarjet më të rëndësishme historike dhe figurat historike që kontribuuan në ndryshimet e kohës.
- f) Mësuesi jep një fotografi, tablo, hartë apo ilustrim nga teksti për temat e përcaktuara për testim dhe i kërkon nxënësit të interpretojë tablonë, fotografinë, hartën historike etj. për ngjarje, fakte apo dukuri historike të përfshira në të.

Për të gjitha modelet e mësipërme vlerësohet nga mësuesi jo vetëm njohuria, por dhe kompetencat dhe konceptet historike kyç.


Mësuesi përcakton edhe kriteret e vlerësimit sipas niveleve të arritjes dhe konvertimin në notë për të ruajtur parimin e transparencës dhe objektivitetit në vlerësim.

### **e. Shkencat e natyrës**

Në lëndët e fushës “Shkencat e natyrës”, mësuesi mban parasysh që të planifikojë veprimtari që mund të realizohen në kushtet e shtëpisë bazuar në tekstin e nxënësit dhe udhëzuesit origjinal të mësuesit që janë përkthim i shtëpive botuese *Pearson*, *Oxford* dhe *Cambridge*, të cilat gjenden në faqen [www.ascap.edu.al](http://www.ascap.edu.al) dhe në facebook: ASCAP.

Nxënësve të pasionuar në shkenca dhe njohës të mirë të gjuhës angleze mund t’u ofrohen edhe linqe online ku mund të përzgjedhin veprimtari të realizueshme në kushte shtëpie, si:

<https://www.explorelearning.com/> (ofrohet në disa gjuhë)





<https://phet.colorado.edu/en/simulations/category/new>  
<https://phet.colorado.edu/en/simulations/category/biology>  
<https://www.udel.edu/biology/ketcham/microscope/scope.html>.

### ***Për vlerësimin me test ose detyrë përmbledhëse në lëndët e shkencave të natyrës***

Mësuesi përzgjedh çështjet më të rëndësishme të gjithë periudhës përkatëse, i udhëzon nxënësit t'i përsërisin dhe të përgatiten për të kryer vlerësimin e periudhës.

Vlerësimi mund të bëhet përmes komunikimit të drejtpërdrejtë të mësuesit me nxënësin në rrjete sociale, ku nxënësi u përgjigjet pyetjeve që mësuesi i drejton për dy-tri tema të periudhës për një kohë rreth 5-7 minuta.


Një model tjetër mund të jetë platforma *google classroom*.

Në shkollat të cilave u mundësohet platforma *google classroom* ([classroom.google.com](https://classroom.google.com)), mësuesi lajmëron paraprakisht të paktën një orë përpara nxënësit për kohën kur do të zhvillohet testimi përmbledhës. Në kohën e fillimit të testimit, mësuesi konfirmon të gjithë nxënësit që janë online. Mësuesi u dërgon testin të gjithë nxënësve në grup. Nxënësit zgjidhin aty për aty individualisht testin në 45 minuta dhe ia dërgojnë mësuesit. Mësuesi vlerëson testet dhe ia komunikon secilit nxënësi individualisht bazuar në kriteret e vlerësimit.

Mësuesi përcakton edhe kriteret e vlerësimit sipas niveleve të arritjes dhe konvertimin në notë për të ruajtur parimin e transparencës dhe objektivitetit në vlerësim.

### ***f. Arsimi fillor (klasat 1-5)***

Për vlerësimin me test përmbledhës në arsimin fillor mund të përdoren modele ushtrimesh të hartuara nga mësuesit, për nxënësit që punojnë në kushtet e shtëpisë. Lidhur me formën e organizimit të testit përmbledhës, mësuesit mund t'u referohen lëndëve më lart.



Shembuj:

▪ **Pyetje me alternativa (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 alternativat).**

1. Cili grupim është i rregullt sipas kohës?

- A) mësova, thashë, piva, këndoja.
- B) lexoi, hëngri, ndenji, takoi.
- C) do të hajë, do të thotë, pyeti, tha
- D) mësoj, punoi, luaj, këndoi.

2. Mendova një numër dhe i shtova 8. Përgjigjja është 14. Sa është numri?

- A) 4
- B) 6
- C) 8
- D) 10


**Pyetje me përgjigje: E vërtetë/ E rreme; Po/Jo; E saktë/E gabuar.**

|   | <i>E vërtetë</i> | <i>E rreme</i> |
|---|------------------|----------------|
| 1. Në ekuacionin $x \cdot 18 + 28 = 100$ , vlera e $x$ është 4.   |                  |                |
| 2. Sipërfaqja e përgjithshme e kubit është $150 \text{ m}^2$ . Brinja e tij është 10 cm.                                  |                  |                |
| 3. Me një tel të gjatë 32 cm formojmë një drejtkëndësh. Gjerësia e drejtkëndëshit është 6 cm. Gjatësia e tij është 10 cm. |                  |                |

▪ **Pyetje me kombinime (me çiftim).**

|  |  |
|--|--|
| Për të përcaktuar gjininë e emrit bazohemi te mbaresa që merr ai në: | përemër në rasën kallëzore.            |
| Fjala “fluturova” është në kohën:                                    | rasën emërore njëjës, trajta e shquar. |
| Kundrinori i drejtë shprehet me:                                     | e kryer e thjeshtë.                    |

▪ **Pyetje me plotësimin e vendeve bosh me informacionin e duhur nga një përkufizim apo proces.**



Plotëso: Fjalë të pandryshueshme janë \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_.

▪ **Pyetje me përgjigje të shkurtër ose me plotësim.**

Jepni një rast kur fjala “dorë” është përdorur në kuptim të parë.

---

Jepni një rast kur fjala “dorë” është përdorur në kuptim të figurshëm.


---

▪ **Pyetje subjektive me përgjigje të kufizuar.**

Një katror me brinjë 8 cm dhe një drejtkëndësh kanë të njëjtin perimetër. Nëse gjatësia e drejtkëndëshit është 12 cm, sa cm është gjerësia e tij?

▪ **Pyetje që vlerësojnë vlefshmërinë e zgjidhjes së një situatë problemore.**

A është vlera e shprehjes  $8 \cdot 7 - 40 + 60 : 6 - 8 : 2 = 22$ ?



## 7.2. Skeda për zhvillimin e mësimit në kushtet e shtëpisë

| Rubrika  |
|--|
| Prezantohet lënda, tema e mësimit dhe rezultatet e të nxënit   |
| Zgjidhen ushtrimet që janë dhënë detyrë shtëpie, në mënyrë që nxënësi të vetëvlerësohet, nëse i ka kryer ato në rregull.   |
| Si lidhet kjo temë me një situatë nga jeta reale. Pse do ta mësojmë këtë temë, për çfarë na shërben në jetën reale në varësi të specifikës së lëndës?  |
| Kujtohen njohuritë paraprake që ka nxënësi dhe që lidhen me këtë temë mësimi.  |
| Përmbledhen konceptet kryesore të temës së re dhe udhëzohen nxënësit se ku do të përqendrohen më së shumti.  |
| Vijohet me dy-tri zbatime nga tema e re, të cilat mund të jenë: <ul style="list-style-type: none"><li>- ushtrime (për ushtrimet jepet një shembull i zgjidhur nga mësuesi);</li><li>- situata nga jeta reale në të cilat zbatohen njohuritë e reja;</li><li>- një detyrë ose koment (nxënësit orientohen se si do të punojnë dhe çfarë pritet prej tyre, si dhe jepet një shembull nga mësuesi);</li><li>- një temë diskutimi (jepen udhëzime nga mësuesi);</li><li>- pyetje që ndodhen në aparatën pedagogjike të tekstit ose që hartohen nga vetë mësuesi (mësuesi orienton nxënësit si të punojnë me kërkesat që ndodhen në aparatën pedagogjike të tekstit, duke dhënë një shembull vetë ai);</li><li>- Etj.</li></ul> |
| Bëhet një përmbledhje e temës së mësimit, duke u përqendruar në njohuritë dhe konceptet kryesore.  |
| Jepen detyrat që do të zhvillohen në kushtet e shtëpisë, për të cilat mësuesi udhëzon nxënësit se si do t'i kryejnë ato.   |

**Shënim.** Secili mësues e përcakton vetë afërsisht se sa minuta mund të zgjasë mësimi online.

